



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 5663 prot.

Roskovec, më 22.07 2024

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE  
PËR PRANIMIN NË POZICIONIN SHEF SEKTORI NË SHËRBIMIN E  
MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN**

Në zbatim të Ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi" Kreu III, neni 14, pika 2 "Kriteret e pranimit në nivelin e mesëm të shërbimit të MZSH-së" dhe neni 15 pika 3 "Emërimi, lirimi dhe përjashtimi i personelit të Shërbimit të MZSH-së", VKM Nr 520 datë 25.07.2019 "Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi"; Vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec Nr. 108 datë 21.12.2023 "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të bashkisë dhe të Ndermarrjeve Vartëse për vitin 2024", Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Roskovec Nr. 2, Datë 05.01.2024 "Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum si dhe organigramës për vitin 2024";

Bashkia Roskovec njofton se në Sektorin e MZSH-së Bashkia Roskovec shpallet 1 (një) vend i lirë pune në nivelin e mesëm në pozicionin :

- **Shef Sektori MZSH-së, në nivelin e mesëm, në Sektorin e MZSH-së, Bashkia Roskovec.**

***Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës.***

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e mara për mbrojtjen nga zjarri, ndërhyrja për shurjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjëse së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut.

***Detyrat e Shefit të MZSH-së :***

Është nëpunës në varësi të Kryetarit të Bashkisë dhe ka këto detyra:

- a) ndërhyt me të gjitha mjetet dhe forcat që disponon për shuarjen e zjarreve, shpëtimin e jetës së njeriut, gjëse së gjallë e pronës, për çdo rast, aksident, incident, fatkeqësi dhe emergjenca të ndryshme;

- b) harton raportin e ndërhyrjes, me forcat, mjetet, taktikën e përdorur, kostot e ndërhyrjes, dëmin e përafërt të shkaktuar nga zjarri;
- c) organizon, inspekton dhe jep asistencë teknike për zbatimin e ligjshmërisë, të normave e të rregullave për sigurinë e jetës së njerëzve, të pronës, nga rreziku i zjarrit;
- d) organizon punën për rritjen e gatishmërinë së mjeteve, pajisjeve e personelit për rritjen e efikasitetit në ndërhyrjen në kohë për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin, në raste fatkeqësish të ndryshme;
- e) organizon stërvitje demonstrative, takime e trajnime me institucione dhe subjekte të ndryshme, për dhënien e njohurive mbi sigurinë nga zjarri;
- f) ndihmon organet e hetimit, me kërkesën e tyre, për hetimin dhe sqarimin e rrethanave e të shkaqeve të rënies së zjarrit dhe bën aktin e ekspertizës teknike;
- g) bashkëpunon me strukturat e Policisë së Shtetit, me institucione të sigurisë publike, strukturat e Forcave të Armatosura, shërbimin e Mbrojtjes Civile, shërbimin e urgjencës mjekësore, për shpëtimin e jetës së njerëzve e të pronës nga zjarri, rreziqet teknologjike, fatkeqësitë natyrore e fatkeqësi të tjera;
- h) përpilon evidenca statistikore për çdo rast ndërhyrjeje e inspektimi dhe i dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të MZSH-së;
- i) kryen studime në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, në bashkëpunim me institucionet studimore, shkencore e projektuese;
- j) njofton, rregullisht, publikun për detyrat dhe masat në fushën e sigurisë nga zjarri dhe shpëtimin, për rreziqet që vijnë në rast zjarresh, fatkeqësish natyrore, teknologjike, si dhe për mënyrën e dhënies së ndihmës në këto raste, përmes formave të ndryshme të informimit.

***Kërkesa të Përgjithshme për pranimin:***

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë përfunduar arsimin e lartë policor, ushtarak, juridik ose inxhinieri, niveli minimal i diplomës “Bachelor”;
- c) Për sektorin e inspektim/parandalimit përzgjidhen kandidaturat që plotësojnë kriteret ligjore dhe që kanë nivelin minimal të diplomës “Bachelor” në degët inxhinieri, juridik;
- ç) Për sektorin e ndërhyrjes përzgjidhen kandidaturat, që plotësojnë kriteret ligjore dhe që kanë përfunduar arsim ushtarak, policor.
- d) Për sektorin e mbështetjes dhe të logjistikës përzgjidhen kandidatë që plotësojnë kriteret ligjore e që janë diplomuar në degët financë dhe ekonomik.
- dh) Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
- e) Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, i Policisë së Shtetit apo nga institucione të tjera të administratës publike;
- ë) Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje

**Dorëzimi i dokumenteve, kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, në Drejtorinë e Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike, të Bashkisë Roskovec deri në datën 06.07.2024 këto dokumenta:**

1. Kërkesë me shkrim drejtuar institucionit të Bashkisë (Drejtorisë të shërbimit të MZSH-së) ,
2. Formular aplikimi për pranim në shërbimin e MZSH-së
3. Fotokopje e ID (kartë identiteti);
4. Çertifikatë familjare;
5. Një kopje të jetëshkrimit( CV);
6. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
7. Diplomë ,listë notash /Deftesë të njësuar me origjinalin të arsimit të mesëm (minimalisht);
8. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton “gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar”;
9. Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi i fundit ( nëse ka);
10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;
11. Vërtetim i gjendjes Gjyqesore (Dëshmi Penaliteti )
12. Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);
13. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);

**Fusha kryesore të njohurive :**

- ❖ Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë , e azhurnuar
- ❖ Ligjin nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- ❖ Ligji nr.152, datë 21.12.2015 ‘Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.
- ❖ VKM Nr 520 datë 25.07.2019 “Për miratimin e rregullores për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi

Kandidatët e pa kualifikuar do te njoftohen në mënyrë elektronike /email-mesazh për arsyet e mos kualifikimit , ata kanë të drejtë të ankohen në njësinë përgjegjëse, brenda 5 ditëve pune nga data e njoftimit dhe e shpalljes së listës dhe ankuesi merr përgjigje ,brenda 5 ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

**KRYETAR**  
**Majlinda Bufi**